ASGJË E MIRË NUK HUMBET TEK ALL-LLAHU I MADHËRUAR..!

SHENJA E HAVARIXHËVE NË ÇDO KOHË DHE NË ÇDO VEND

MIRËSIA E TUBIMEVE ME RASTIN E MEVLUDIT

Viti 17 - Nr. 1 (191),
Janar, 2019

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Elhamdulilah

PËR UDHËZIMIN NË ISLAM.., VETËM KAQ!

"Kjo fé ka garancinë e Zotit të botëve, nuk ka nevojë për mbrojtjen e askujt! Ndërsa ne, teksa disiplinohemi me të, thërrasim popullin tonë drejt saj dhe edukojmë fëmijët tanë me dritën që na ndriçon rrugët e jetës, nuk bëjmë gjë tjetër, veçse i dëshmojmë All-llahut të Madhëruar mirënjohjen dhe përuljen tonë që na udhëzoi drejt dritës së Tij!"



ASGJË E MIRË NUK HUMBET TEK ALL-LLAHU I MADHËRUAR..!

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të gjithësisë; Krijuesit të gjithçkaje, pa pasur nevojë për asgjë; Furnizuesit të gjithësisë, pa e dëmtuar asgjë pushtetin e Tij; të Përhershmit pa fillim, të Përhershmit pa mbarim, i Cili i dha njeriut mundësinë e udhëzimit dhe përfitimit nga mëshira e Tij, për të cilën tha: "Mëshira Ime e ka tejkaluar zemërimin Tim!"

Salavatet dhe selamet më të përzemërta, të shoqëruara me dashni e mall, ia dërgojmë sot, në këtë ditë e në çdo moment të jetës sonë, Ma të Mirit e Ma të Shtrenjtit, Hz. Muhammedit (a.s.), i cili na u drejtua me disa këshilla të mrekullueshme, që kam dëshirë të jenë boshti i këtij komunikimi javor.

Imam Muslimi ka regjistruar transmetimin e sahabiut Ebu Hurejra (r.a.), nga i Dërguari i All-llahut (a.s.), që ka porositur:

"**1**- Kushdo që ia largon një besimtari një brengë nga brengat e kësaj bote, All-llahu do t'ia largojë një brengë nga brengat e ditës së kijametit!

2- Kushdo që e lehtëson dikë në vështirësi, All-llahu do ia lehtësojë atij në këtë botë dhe në të përtejmen!

3- Kushdo që e mbulon të metën e një muslimani, All-llahu do ta mbulojë të metën e tij në këtë botë dhe në të përtejmen!

4- All-llahu është në ndihmë të robit, sado që ai është në ndihmë të vëllasë së tij!

5- Kushdo që ndjek një rrugë, në të cilën kërkon dije, All-llahu do ia lehtësojë atij rrugën drejt xhennetit!

6- Saherë që një popull mblidhen në një shtëpi prej shtëpive të All-llahut, duke lexuar Librin e All-llahut dhe duke e përsëritur atë në mes tyre; mbi ta do të zbresë qetësia, do t'i mbulojë mëshira, do t'i rrethojnë melekët dhe do t'i përmendë All-llahu tek melekët pranë Tij!

7- Këdo që e vonon puna e tij, nuk e do e shpejtojë prejardhja e tij!".

TË DASHUR BESIMTARË,

Hadithi në fjalë është sistem jete për muslimanin! Sistem i ndërtuar mbi besimin e pastër në Njësinë e Zotit të vetëm të gjithësisë; besimit në jetën e përtejme dhe llogarinë para duarve të Krijuesit të gjithësisë; ndihmës ndaj tjetrit me të gjitha mundësitë, me zemër të gatshme e gjymtyrë që i binden thirrjes së brendshme; mbylljes së syve para të metave të kujtdo prej krijesave të Zotit, duke menduar mirë e duke mos paragjykuar veprimin e askujt, sepse llogaria e tjetrit nuk është kompetencë e njeriut; rrugëtimit të përhershëm drejt dijes dhe rrugëve të saj, për të jetuar në këtë jetë të përkohshme me dinjitetin e kërkuesit të dijes, i cili ka përherë bekimet e Zotit; angazhimit për të mbajtur të gjallë Fjalën e Zotit dhe udhëzimin e Tij, nëpërmjet leximit të vazhdueshëm të Fjalës së Tij dhe përsëritjes së saj, sepse lënia pas dore e leximit të Fjalës së Zotit, i jep mundësi abuzuesve me Librin e dhe Fjalën e Tij, për të deformuar atë mirësi të madhe të mbrojtur nga Vetë Zoti i tanësisë; si dhe mbështetja tek besimi dhe vepra personale, jo tek llagepet e kësaj bote, a prejardhja! Nuk ka vlerë a je djali i të Dërguarit të All-llahut, a nipi i tij, ka vlerë vepra e jote, morali dhe sjellja, dalja për zot e përgjegjësive që ke marrë mbi supe në jetë, mënyra se si sillesh me familjen tënde, njerzilleku në komunikim, distancimi nga arroganca dhe mendjemadhësia në jetë, le të jesh kush të jesh; nëse tentakulat e arrogancës dhe vetëkënaqësisë të kanë prekur zemrën e mendjen, të kanë prishur!

TË DASHURIT E MI,

Mundësitë për të ndihmuar e bërë mirë, sidomos sot, janë të shumta! Ka njerëz të mbytur në borxhe, ka varfëri ekstreme, ka brenga dhe vështirësi, që vetëm Një Zot i di! Kërkoni për ta, ndihmojini me sa të keni mundësi, duke mos e nënvleftësuar asnjëherë të mirën që bëni, sepse e mira e sinqertë tërheqë bekimet dhe mëshirën e Zotit të gjithësisë!

Haxhilerët dhe umrexhitë e viteve të fundit, besoj se i kanë në hatër dy emra në qytetin e Mekës; "Bajk" dhe "El-Fekih". I pari është emri i një rrjeti restorantesh, që tregtojnë mish pule, në stilin e ushqimeve të shpejta. Përherë ka rrallë të madhe në këtë rrjet. Sekreti i kësaj mbarësie fshihet tek veprimi i themeluesit, i cili kishte bërë nijet, që për çdo porosi që do merrte, do nxirrte 1 rijal sadeka. Pas vdekjes së tij, të bijtë e vijuan traditën e të atit, duke e rritur atë nga 1, në 2 rijalë për çdo porosi!

Xhamia e madhe "El-Fekih" në lagjen Azizije, i shërben një komuniteti të madh njerëzish, që vijnë të falen në të vaktet ditore dhe namazin e xhumasë. Përballë saj, në njërën prej selive të familjes "El-Fekih", që njihet edhe si një ndër bizneset më të afirmuara të tregtimit të mishit të pulës dhe produkteve të ndryshme, që nxirren prej saj, gjatë krejt sezonit të Haxhit do të gjesh një radhë të madhe njerëzish që presin çdo ditë shërbimin falas të një vakti a më tepër nga kjo familje. Është një sadeka e rrjedhshme e trashëguar nga themeluesi i këtij biznesi, poashtu!

Edhe tek ne ka plot njerëz të mirë, biznesmenë a jo, që ndihmojnë me sadekatë dhe zekatin e pasurisë së tyre dhe janë afër njerëzve në nevojë, të sëmurëve, të brengosurve, borxhlinjve, të burgosurve, nxënësve të dijes, institucioneve fetare e atyre arsimore, me ndihma e përkrahje, All-llahu i shpërbleftë dhe e shtoftë sojin e tyre!

Asgjë e mirë nuk humbet tek All-llahu i Madhëruar..! Nuk të shkon dëm vlera e sadekasë, sado e vogël qoftë ajo! Nëpërmjet saj, All-llahu i Madhëruar të shton bereqetin në jetë, të mbron nga një e keqe, të largon një shqetësim, të pastron nga gjynahet, të ruan nga një e papritur e shumë më shumë se kaq!

Subhanallah, sot, teksa po bëhesha gati për të ardhur në xhami, më telefonoi njëri prej imamëve tanë të nderuar. Në fund më tha: "Mora edhe pakot e përmuajshme të filanit (një biznesmen) për t'ia shpërndarë një liste familjesh në nevojë", në një prej fshatrave tanë. Elhamdulilah!

T'i rikthehemi herë pas here leximit të këtij hadithi të mrekullueshëm dhe ta përvetësojmë në jetë, për të gjetur kënaqësinë dhe bekimet e tij në jetën tonë!

(Hytbeja e xhumasë, mbajtur në xhaminë e Parrucës, Shkodër, 18 janar 2019)

HZ. NUHU (A.S.), THIRRËSI QË NA FRYMËZON NË NJË RRUGËTIM TË SHENJTË...

Në Kur'anin Famëlartë lexojmë një sure me emrin e të dërguarit të All-llahut, Hz. Nuhut (a.s.). Është e jashtëzakonshme përpjekja dhe sakrifica e këtij burri të madh, në rrugën e Thirrjes drejt besimit dhe vlerave.

Të lexojmë me vëmendje: "Dhe sa herë që unë i thërrisja ata për t'u falur Ti atyre gjynahet, ata i vinin gishtat e tyre në veshë dhe mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në të tyren me një mendjemadhësi të fortë! Pastaj, unë i thirra ata haptazi. Pastaj unë thirrjen ua drejtoja atyre haptazi, e shumëherë edhe fshehurazi!" - (Nuh: 7-9).

Ajo që vihet re në mënyrë të qartë është përpjekja e vazhdueshme dhe mos dorëzimi i të dërguarit të All-llahut për të ftuar popullin e tij në besim, në vlera, në udhëzim e dritë, përtej paudhësisë dhe devijimit ekstrem të tyre.

Kjo na frymëzon që në rrugën e thirrjes sonë, të mos thyhemi e të mos dobësohemi, sa herë që dikush, djathtas a majtas, përpiqet të na frenojë e të na ndalojë në misionin tonë të shenjtë! Absolutisht, jo! Ne jemi thirrës në gjurmët e të parëve të ndershëm, që edhe jetën e dhanë në këtë rrugë, por asnjëherë nuk hoqën dorë! Të heqësh dorë nga kjo rrugë, tek ne, është blasfemi!

Në suren, që mban emrin e Hz. Hudit (a.s.), lexojmë reagimin e çuditshëm të popullit të Nuhut, kundër zotërisë së tij: [Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: "Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne, ne nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtërit e më mendjelehtit nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne, përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtarë!"] - (Hud: 27)

Mësim me rëndësi: Sa më shumë që të sulmohet e vërteta dhe njerëzit e saj; sa më shumë që të shtohet arroganca dhe fyerja, sharjet dhe primitivizmi në komunikim, aq më tepër duhet që njerëzit e Thirrjes të motivohen për të vazhduar me këmbëngulje të madhe dhe mbështetje në Zotin e botëve, rrugën e tyre drejt përhapjes së vlerave të besimit!

Në fund të fundit, nuk ka asnjë dyshim në mbështetjen e Krijuesit, në dorën e të Cilit është gjithësia, përfshi edhe ata që e mohojnë dhe luftojnë ditënatë që të shuhet drita e Tij! Premtimi i Tij do të lexohet deri sa të ndriçojë dielli mbi këtë botë: "Ne patjetër do të ndihmojmë të dërguarit tanë në jetën e kësaj bote, edhe ata që besuan, e edhe në ditën e prezentimit të dëshmive!" - (El-Gafir: 51)

Prandaj, sfida e jonë është sfidë fisnike dhe më e shenjta e rrugëve që të nderon në këtë botë dhe në të përtejmen!

Në rrugën tonë nuk ka dorëzim..!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 7/1/2018



SHENJA E HAVARIXHËVE NË ÇDO KOHË DHE NË ÇDO VEND

Shejkh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

Unë tërheq vëmendjen ndaj kulturës së helmuar, e cila u prezantohet djemve të rinj! Kujtoj, se pas zaptimit, që një grup të rinjsh i bënë Haremit të Mekës (Qabes), i thashë një personi me përgjegjësi: Këta janë viktimë e një ideje të shtrembër dhe një arsimimi të mashtruar. Shembuj të ngjashëm kam parë në shumë kryeqendra islame, që u mësohet injoranca dhe ekstremizmi prej njerëzve, të cilët kanë emra, por ato nuk kanë përmbajtje.

Në sytë e njërit prej tyre pashë nijet shkatërrimtari, ndërkohë që po i kujtoja me qetësi, se myftiu tek ne, që pesëdhjetë vjet më parë ka shkruar një libër me temë: "Fjala e mjaftueshme në lejimin fotografimit". Por, ne, edhe sikur të supozonim se ai është gabim, nuk ka dyshim, se ndryshimet fikhore (interpretuese të ndonjë çështjeje) për një çështje të caktuar, e nxjerrin atë prej rrethit të urdhrit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, kështu që nuk ka kuptim për gjithë këtë urrejtje të akumuluar kundër fotografimit dhe fotografëve! Por, të riut i qitnin shkëndija sytë me shikime shkatërruese.

Aty e kuptova, se unë isha përballë një fëmije të paedukuar, që i ishte bashkangjitur një xhemati fetar, sepse ai nuk kishte gjetur një grup plaçkitës, që të bashkohet me ta, që t'u pres rrugën njerëzve; ai ishte shkatërrimtar me rroba predikuesi (vaizi)! E megjithatë, ai ishte viktimë e atyre që flasin për fe, të cilët kanë humbur drejtësinë dhe ekuilibrin dhe që përzgjedhin thëniet e ndryshme (fikhore) në çfarë iu përshtatet shijeve të tyre, që ndoshta mund të jenë jo të sakta, pastaj atë që përzgjedhin e prezantojnë, sikur ajo është feja e vetme, megjithëse ajo që kanë përzgjedhur është mendimi më i dobët, por edhe sikur të ishte mendim i saktë, nuk lejohet të paraqitet, veçse ai është një mendim dhe kaq, e jo akide (besim), që prej saj lind blasfemia (kufri) dhe besimi (imani).

Historia e diturisë së myslimanëve është shumë herë më fisnike, sesa historia e tyre politike dhe se përpjekjet e dijetarëve (imamëve) dhe edukatorëve interpretues dhe tradicional (pasues të të tjerëve), ato janë që e kanë ruajtur Islamin, përkundër gjithë asaj që ka goditur aparatin pushtetar prej defekteve të mëdha.

Po, në historinë tonë të diturisë ka gjëra që meritojnë të kritikohen dhe të siten, por në esencë ajo është histori mendimi serioz, mundë i sinqertë dhe det me dallgë të trazuara me dhunti dhe botëkuptime që meritojnë studim.

Kurrë nuk është bashkuar ymeti në humbje (dalalet) dhe asnjëherë nuk njihet ndonjë shenjtëri, përveç fjalës së të mbrojturit nga gabimet {të Dërguarit të Allahut (a.s)}. Ditën që njeriu vjen nga lugina e Nilit apo shkretëtira e Nexhdit për të hedhur pluhur mbi gjithë këtë trashëgimi, ai në të vërtetë ka prerë arteriet e jetës nga brezat e ardhshëm dhe të pritshëm.

Ai me këtë gjë, me vetëdije apo me budallallëk, i shërben sulmeve kolonialiste ndaj vatrës së Islamit. Kjo na tërheq vëmendjen me forcë, se ajo që i thuret Islamit natën është më e rëndë dhe më e tmerrshme, sesa ajo, me të cilën ndeshet në dritën e ditës.

Komplotet thuren me shumë ligësi për shkatërrimin e të sotmes dhe të nesërmes sonë, e vegël e kësaj nuk janë vetëm qeveritë e shitura apo grushtet ushtarake të fabrikuara, por vegël e kësaj është depërtimi në aparatin e thirrjes (davetit) në çfarëdo lloj pike dhe zbatimi i tyre nga brenda xhematëve islame për të vazhduar, në njëfarë mënyre, një punë më depërtuese (shkatërruese), për të eliminuar aktivitetin islam dhe për të mbyllur dyert e jetës përpara tij.

Për këtë arsye, i bëjmë thirrje të rinjve myslimanë, që të jenë të zgjuar dhe kujdestarëve myslimanë, që të kontrollojnë fjalët dhe dispozitat e tyre, e të mos i japin armikut shansin (mundësinë), që të sulmojë përmes tyre.

Keni kujdes ndaj atij, që i kushton rëndësi formës dhe harron (neglizhon) përmbajtjen.

Keni kujdes ndaj atij, që nxit përçarje dhe nuk i kushton rëndësi xhematit (unitetit).

Keni kujdes ndaj atij, që ngjitet përmes degëve për tek rrënja apo zbret nga rrënja për tek degët.

Keni kujdes ndaj atij, që zgjat gjuhën ndaj nesh dhe nuk flet asnjë fjalë të vetme për armiqtë.

Kam parë të tillë, që nuk kanë shkruar qoftë edhe një germë për sionizmin, kryqëzatat, komunizmin apo ateizmin, e megjithatë kanë shkruar libra kundër myslimanëve, ku ndoshta kanë qenë gabimtarë apo të saktë.

Çfarë të bëri të heshtësh këtu, e të flasësh atje?! Nëse nuk je agjent i armikut të Allahut, atëherë ne nuk kemi nevojë për budallenj, të cilët i irritojnë gjërat e vogla dhe i qetësojnë gjërat e mëdha!! Apo, ata të cilët janë të ashpër ndaj besimtarëve dhe të dhembshur ndaj jobesimtarëve! Shenja e havarixhëve në çdo kohë dhe në çdo vend!

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

ELHAMDULILAH PËR UDHËZIMIN NË ISLAM.., VETËM KAQ!

Ca portale me emra tërheqës; herë qytetesh e herë historie, herë lokalë e herë kombëtarë, që në të shumtën e rasteve nuk u dihen të zotët, herë pas here mbjellin mllef dhe urrejtje, që nxit konflikt mbi baza fetare. Kjo cytje tinëzare, ngjan me një shkëndijë të papërfillshme, që mund të shkaktojë çfarë nuk i dihet fundi..! E bëjnë këtë duke fyer muslimanët, teksa prekin shenjtëritë e tyre, duke shkelur mbi dërrasa të kalbura..!?

Hera-herës ka edhe plot emra të përveçëm, në pamje të parë muslimanë, që s'lënë rast e mundësi, pa nxjerrur krye me helmin e tyre, tamam si gjarpri që nxjerr veten në pozitë sulmi, me gjuhën e tij dredharake..!?

Kjo lloj propagande është tipike e atyre që përgjatë historisë kanë punuar dhe punojnë fort për të luftuar Islamin dhe përhapjen e tij të jashtëzakonshme, sidomos sot, në Evropë dhe në mbarë botën, si dhe në rastin tonë shqiptar (në Kosovë dhe Shqipëri), teksa nuk lënë përpjekje e mundësi për të njollosur imazhin e tij, duke nxitur tema që u ka perënduar dielli pa u lindur fare, duke mbjellur mëdyshje në mendjet e besimtarëve, duke promovuar modele të reja të "Thirrjes Islame" bashkëkohore, që keqlexon tekstet e shenjta dhe bën interpretime devijante, duke derdhur lotë krokodili për çështjen e femrës dhe trajtimin e saj në Islam, duke folur mbi mospërputhjen e botëkuptimit islam me mendësinë dhe kulturën perëndimore, duke tërhequr vëmendjen drejt elimininit të disa ajeteve kur'anore (hasha!), sikundër "pastrimin" e librave të hadithit nga disa sosh, qofshin edhe në gjashtë librat më të mirënjohur të tij (hasha!), përhapjen e jomedhhebizmit, nxitjen e debatit për çështjet e ndryshme juridike islame në mesin e njerëzve, mbjelljen e anarshisë brenda xhamisë tonë, abuzimin me simbolet e dijes dhe përkushtimit, intriga publike me nxitjen e debateve shterpë, si rastet meskine të disa gazetarëve të dalë boje, që përflasin herë pas here hixhabin, muslimanet në plazhe, burkën, e të ngjashme. Si të thuash, luftë nga jashtë e intriga të mbjellura nga brenda!?

Përballë kësaj vale, që nuk soset, as gjen karar, muslimani duhet të vetëdijesohet drejt disa të vërtetave të mëdha, para të cilave, s'duhet të lejojë shejtan në botë ta provokojë për t'i tejkaluar ca caqe të shënuara nga udhëzimi hyjnor:

1. Janë të qarta ajetet kur'anore: "Ti praktiko atë që t'u shpall nga Zoti yt. S'ka Zot, përveç Tij. Largohu prej idhujtarëve. E sikur të donte All-llahu, ata nuk do të ishin idhujtarë. Ne nuk të bëmë përcjellës të tyre e as që je mbikëqyrës i tyre. Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne ia kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan." – (El-En'am: 106-108).

Nëse ke vendosur të reagosh, gjej formatin më elitar, rrugët më bindëse, platformën më të qytetëruar dhe asnjëherë mos degrado në nivele të ulëta, duke rënë në grackën e sharjes së fesë, besimit e shenjtërive të tjetrit!

Kurrë mos ia lejo vetes t'i fyesh tjetrit besimin që ka, edhe nëse ai lloj besimi bie ndesh me atë që ti beson! Në fund, të gjithë do japim llogari para Zotit dhe vetëm Atij i takon gjykimi final në ditën e gjykimit!

Asnjëherë në historinë tonë islame, nuk janë fyer as poshtëruar jomuslimanët për shkak të fesë! Asnjë rast! E kundërta, po, me qindra raste plot fakte kokëforta! (Lexoni së fundmi për genocidin ndaj muslimanëve rohinga dhe atyre ujgurë, ose para tyre, jo shumë larg në kohë; boshnjakët e shqiptarët!?).

Nëse dikush i ditur kërkon dialog ballafaques për çështje të ndryshme të fesë, absolutisht që jemi në gjendje dhe të gatshëm në çdo moment dhe për çdo lloj komunikimi të qytetëruar, me dëshirën e mirë të udhëzimit të kujtdo drejt të vërtetave të mëdha të besimit e fesë!

2. Lexo me vëmendje dhe lartësohu në kërkim të kënaqësisë së Zotit tënd, i Cili urdhëron: "Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë!" – (El-Munafikune: 8).

Jeto me dinjitetin e qenies musliman, krenar me fenë tënde, krenar me Librin tënd, krenar me pejgamberin tënd, krenar me shenjtëritë e tua, krenar për praktikimin tënd të udhëzimit të fesë, krenar për përhapjen kudo të kësaj drite hyjnore! Vetëm me krenari legjitime!

3. Lexo me vëmendje udhëzimin dritësues: "E, s'ka dyshim se ata që thanë: "All-llahu është Zoti ynë", dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë melekët (në prag të vdekjes dhe u thonë): të mos frikësoheni, të mos pikëlloheni, keni myzhde xhennetin që u premtohej. Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, ku do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkoni. Pritje e nderuar prej Atij që falë gjynahet dhe që është Mëshirues! E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam prej muslimanëve?" Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që janë të durueshëm, dhe nuk mund ta arrijë kush, pos atyre që kanë virtyt të lartë!" – (Fussilet: 30-35).

Këto ajete duhet të na prijnë në jetën tonë, teksa ftohemi përherë e më shumë drejt qëndrueshmërisë në besimin tonë, plot vendosmëri burrash që e dijnë mirë se ajo që besojnë dhe ajo ku bazohen është prej Zotit të botëve; pa mashtrime e pa fallsifikim, pa lojra fjalësh e pa intriga, pa zigzage e larg mbulimit të arsyes, mendjes së shëndosh dhe logjikës së ftohtë: "(Ky është) Libri, që të është zbritur ty, që me të t'ua tërheqësh vërejtjen dhe t'i kështillosh besimtarët, pra të mos ketë shtrëngim në gjoksin tënd (për kumtimin e tij). Pasojeni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj, e mos zini miq (përkrahës) pos Tij. Pak është ajo që po merrni përvojë!" – (El-A'raf: 2-3).

Kjo fé ka garancinë e Zotit të botëve, nuk ka nevojë për mbrojtjen e askujt! Ndërsa ne, teksa disiplinohemi me të, thërrasim popullin tonë drejt saj dhe edukojmë fëmijët tanë me dritën që na ndriçon rrugët e jetës, nuk bëjmë gjë tjetër, veçse i dëshmojmë All-llahut të Madhëruar mirënjohjen dhe përuljen tonë që na udhëzoi drejt dritës së Tij!

Elhamdulilah për udhëzimin në Islam.., vetëm kaq!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 13/1/2019

MIRËSIA E TUBIMEVE ME RASTIN E MEVLUDIT

Imam Didmar Faja*

Tubimet në të cilat kujtohet Hz. Muhamedi (a.s.) dhe mirënjohja që i kushtohet Allahut (xh.sh.) për dërgimin e Profetit të Tij të dashur, janë padyshim tubime të vlefshme. Këto tubime ose mevlude, në të cilat Profeti (a.s.) përmendet shpesh, konsiderohen si risi të këqija nga disa, të cilët janë literalistë në kuptimin e Kur'anit dhe traditës profetike, sunnetit. Refuzim i tyre zakonisht përmban thënie të tilla si: "Nëse Profeti nuk është mbledhur për raste të tilla, dhe ne nuk duhet të mblidhemi."

Më pas, këtë e ndërthurin me devijimin nga rruga e drejtë Islame (ashtu siç e kanë zakon dhe për shumë çështje të tjera Islame, të cilat nuk janë definitive) dhe citojnë hadithin e Pejgamberit (a.s.) se "çdo risi është humbje dhe çdo humbje përfundon në xhehennem". Ky artikull i shkurtër, ka për qëllim të hedh poshtë keqinterpretime të tilla, duke mos hyrë në detaje, por duke u përqendruar vetëm në një nga ajetet Kur'anore dhe në një hadith të saktë, me një koment racional, që mbështet tubimet e mevludit.

Çdo besimtar musliman duhet të ndiej gëzim dhe lumturi për ardhjen e Profetit Muhamed (a.s.) në këtë botë. Një gjë e tillë përmendet në Kur'anin Fisnik me këto fjalë: "Thuaj: Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij - vetëm me këto le të gëzohen! Kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë." (Kur'ani, 10: 58). Edhe pse disa kuptime të ndryshme simbolike janë dhënë rreth fjalës "dhunti" dhe "mëshirë" nga komentuesit e Kur'anit (mufessirët), kushëriri i Profetit, Abdullah Ibn Abbasi (r.a.) i ka dhënë një kuptim të veçantë këtyre dy fjalëve.

Ai thotë se fjala "dhunti" simbolizon diturinë, ndërsa fjala "mëshirë" simbolizon Profetin Muhamed (a.s.). Ai gjithashtu gërsheton këtë konstatim me përmendjen e ajetit tjetër përkatës nga Kur'ani, në të cilin Profeti Muhammed (a.s) është përshkruar si "mëshirë për botët". Thuhet në Kur'an: "Dhe Ne nuk të dërguam ty, [O Muhammed], përveçse mëshirë për botët" (Kurani, 21: 107). [Jalal el-Din Sujuti, El-Durr el-Manthur Fi Tefsir Bil-Me'thur, Merkez Hixhr lil Buhuth ve el-Dirasat el-Arabiyyeh ve al-Islamij-jeh, Kairo, 2003, vol. 7, fq. 668.]

Sipas këtij shpjegimi, kuptohet se besimtarët duhet të ndjejnë gëzim për ardhjen e Profetit (a.s.) në këtë botë. Ky gëzim mund të shprehet në mënyra të ndryshme. Pejgamberi (a.s.) i ka udhëzuar muslimanët që t'i luten Zotit për të, në mënyrë që Zoti të dërgojë bekimet dhe mëshirën e Tij mbi Pejgamberin (a.s.).

I Dërguari i Allahut i ka udhëzuar gjithashtu besimtarët të agjërojnë të hënave, sepse ai vetë erdhi në këtë botë ditën e hënë. Këto janë të gjitha forma të ndryshme për të shprehur dashurinë dhe gëzimin për ardhjen e Pejgamberit (a.s.) në këtë botë. Sidoqoftë, ai nuk i ndaloi ata për shprehjen e gëzimit në forma të tjera, përderisa ato forma nuk bien ndesh me etikën dhe legjislacionin Islam. Hadithi në vijim do të shtjellojë më shumë mbi pranueshmërinë e këtyre formave të ndryshme të shprehjes së këtij gëzimi, në veçanti tubimet.

Shoku i Pejgamberit (a.s.), Ebu Saīd el-Khudrī (r.a.), transmeton se Muāvijeh (r.a.) ka thënë: "I Dërguari i Allahut u paraqit në një tubim, - d.m.th ku gjendeshin shokët e tij, dhe tha: "Çfarë po bëni? Ata thanë: "Ne jemi grumbulluar së bashku për t'iu lutur Allahut dhe për ta lavdëruar Atë për udhëzimin në fenë e Tij dhe që na bekuar me ty." Ai tha: " Pu ju pyes: Pash Allahun! Nuk jeni tubuar, përveçse për atë gjë?" Ata thanë: "Pasha Allahun! Nuk jemi tubuar së bashku për ndonjë arsye tjetër. Ai tha: "Unë nuk kërkoj nga ju që të betoheni për shkak të ndonjë dyshimi, por Xhebraili (a.s.) erdhi tek unë dhe më tha se Allahu i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar lavdërohet me ju tek engjëjt." [Ky është hadith i saktë (sahih), që përcillet nga Imam Bejhekiu në librin e tij, Shuabul-Iman, Maktebeh el-Rushd, Riad, 2003, vëll. 2. fq. 70.

Imam Taberaniu gjithashtu e ka renditur në librin e tij Mu'xhem, kështu dhe Imam Muslimi, Tirmidhiu, Nesaiu, Ahmedi dhe transmetues të tjerë të haditheve e kanë përcjellë këtë hadith me një zinxhir të saktë transmetimi. (Zoti i mëshiroftë të gjithë)]

Përmes këtij hadithi shprehet qartë synimi i shokëve të Profetit (as). Ata u tubuan ta lavdërojnë Allahun për dy arsye: Arsyeja e parë ishte për shkakun e udhëzimit të tyre në Islam, ndërsa arsyeja e dytë ishte që ta falënderonin Atë për dërgimin e Hz. Muhammedit (a.s.). Ky tubim i tyre nuk ishte një praktikë e detyrueshme fetare, por një përpjekje e përbashkët, duke u bazuar në zgjedhjen individuale të sahabeve për të shprehur gëzimin e tyre ndaj Zotit, për dërgimin e Pejgamberit. I Dërguari i Zotit e pranoi përpjekjen e tyre dhe konfirmoi miratimin e Allahut dhe kënaqësinë e Tij, në veprimin e tyre të pëlqyeshëm.

> "Unë nuk kërkoj nga ju që të betoheni për shkak të ndonjë dyshimi, por Xhebraili (a.s.) erdhi tek unë dhe më tha se Allahu i Plotfuqishëm dhe i Madhëruar lavdërohet me ju tek engjëjt."

Prandaj, tubimet e mevludit, në të cilat madhërohet Allahu dhe kujtohet i dashuri i Tij, janë me të vërtetë shprehje gëzimi ndaj atij që Allahu e dërgoi dhe e përshkroi si: "Mëshirë për botët" Çdo përpjekje për ndalimin e tubimit të mevludit që përputhet me normat Islame, ose etiketimi i tyre si të paligjshme dhe të ndaluara, s'është asgjë tjetër, por përpjekje në reduktimin e horizonteve Islame dhe ndalesë në atë që thërret Kur'ani dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi Profetin tonë Muhammed, familjen e tij të dashur dhe shokët e tij të nderuar.

---

* Drejtues dhe imam i United Islamic Center of Arizona (UICA), ShBA.

RAPORTI I SINQERTË ME ALLAHUN, ÇELËS I ÇDO MBARËVAJTJEJE NË JETË

Ervil Kuçi,
Imam - xhamia Dërgut

Një vit nga jeta jonë sapo iku, bashkë me të shumë sprova, vështirësi, dështime, zhgënjime… por njëkohësisht dhe momente gëzimi, suksesi, mirësi dhe begati, një vit nga jeta jonë nuk është shumë por as nuk është pak për të përjetuar të gjitha këto ndjesi, ndërsa një vit ikën dhe i lë hapësirën një viti të ri plot mister, një të ardhme ndoshta të mbushur me sprova dhe vështirësi por ndoshta e mbushur edhe me sukesese, arritje dhe begati, nje të ardhme që e di vetëm Allahu, Zot i Gjithësisë.

Ndërsa analizojmë jetën tonë nga kjo pikëpamje, dashje pa dashje në fundin e vitit që shkoi dhe në fillimin e vitit të ri që po afron,mund të na lindin në mënyrë spontane si për apelim vetes, këto pyetje: Si ishte për mua ky vit? Sa u sprovova këtë vit? Sa pata sukses këtë vit? Sa plane që kisha në mëndje arrita të realizoj këtë vit?

Të gjitha këto pyetje mund të lindin tek secili prej nesh, pyetje që i përkasin jetës sonë të përditshme dhe asaj materiale. Të njejtat pyetje plot dilemë mund të na lindin dhe për vitin e ri që po afron… dhe nëse kërkojmë përgjigje, do të ishte me vend që të gjitha këto pyetje t'i përmbledhim në një pyetje të vetme e cila është dhe çelësi i përgjigjes për të gjitha ato pyetje, por që në të njëjtën kohë i lë hapësirë dhe ndjesisë së besimit në Zot, i cili është esenca e mbarëvajtjes së çdo gjëje në jetën e kësaj bote dhe asaj të përtejmes.

Pyetja që vlen dhe përgjigjia e saj, për të dyja rastet si për vitin që shkoi dhe atë të riun që po afron do të ishte : Si e kisha raportin me Allahun vitin që shkoi ? dhe Si do të jetë raporti im me Allahun këtë vit plot mister?

Nëse do të jemi kuriozë të dimë se ku është lidhja e kësaj përmbledhje pyetjesh në një pyetje të vetme e cila, përgjigjia e saj është çelësi i të gjitha përgjigjeve. Është se çdo gjë që ndodh në jetën tonë të përditshme fillon dhe mbaron tek raporti me Allahun. Sprovat, vështirësitë, fatkeqësitë, dështimet, zhgënjimet, gëzimet , sukseset, arritjet, begatitë dhe mirësitë, të gjitha këto kthehen tek një pyetje e vetme : Si ishte raporti im me Allahun kur u sprovova në filan ditë vitin që shkoi? Kur dështova në filan ditë në diçka … kur u zhgënjeva në filan ditë prej dikujt … Si ishte raporti im me Allahun kur më erdhi një mirësi … kur arrita sukseset .. kur isha në rehati dhe në begati …? Të gjitha këto kanë lidhje në raportin tënd me Allahun … nëse ke pasur raportin e mirë.. në çdo vështirësi ke ndier mbështetjen e Tij.. në çdo dështim ke ndier lehtësimin prej Tij dhe kurajon për të rinisur nga fillimi me emrin e Tij, në çdo fatkeqësi ke ndier forcën prej Tij duke u dorëzuar plotësisht në kaderin e Tij, dhe nëse ke pasur një raport të mirë me Allahun, në çdo situatë të vështirë je bërë më i fortë dhe më i pjekur, më i durueshëm dhe më i matur, dhe më i ditur, sepse raporti i mirë me Allahun të ka shtyrë që të kuptosh së çdo sprovë apo vështirësi prej Tij është në favorin tënd sepse mëson si të luftosh në jetë dhe njëkohësisht t'i mbështetesh Atij për rrugëzgjidhje.

Nëse ke pasur një raport të mirë me Allahun… në sukeset dhe arritjet tuaja nuk je dehur nga gëzimi aq sa të mos kujtosh prej nga të erdhi ai sukses … por je ndalur disa çaste ne vetmi dhe ke kuptuar se ky sukses të erdhi nga Allahu, dhe ke ditur ta falënderosh mirësinë e Tij.

Nëse ke patur raportin e mirë me Allahun ke kuptuar qe çdo mirësi dhe begati që posedon në jetën tënde është prej Tij, dhe nuk ke reaguar me arrogancë, por me modesti ke thënë në zemrën tënde , ashtu siç të ka mësuar Zoti yt në Kur'anin e Tij famëlartë : "O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira me të cilat Ti do të jesh i kënaqur". - (Kur'ani, En-Nml: 19)

Çelësi i një raporti të mirë me Allahun, që rregullon jetën tonë të përditshme qoftë në sprova dhe vështirësi, apo në gëzime dhe begati, është një përkushtim dhe bindje e sinqertë ndaj Tij, nëse përkushtimi është i sinqertë atëherë dhe raporti do të jetë i fortë dhe solid, dhe përgjigjet e pyetjeve dhe dilemave do t'i marrësh dita ditës në jetë.

Allahu xh.sh i përgjigjet pyetjeve tona me këtë ajet në suren Et-Talak: "Ai që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë rriskun prej nga nuk e pret".

Pejgamberi (a.s) në një hadith të tij, thotë: "Sikur njerëzit të merrnin këtë ajet do t'i mjaftonte atyre".

Kush i frikësohet Allahut në çdo gjë që ka ndaluar, kush i përkushtohet Atij në çdo gjë që ka urdhëruar, kush i bindet Atij me mëndje dhe me zemër, ka një raport të sinqertë dhe një besim solid, jo të luhatshëm. Dhe nëse ke këtë raport të mirë s'do të thotë se patjetër nuk do të sprovohesh apo nuk do të hasësh vështirësi në jetë, apo patjetër do të vijnë vetëm mirësi dhe begatinë jetë. Të kesh një raport të sinqertë me Allahun do të thotë të dish të mësosh nga sprovat dhe durosh në to, të dish të falënderosh në begati dhe rehati dhe te mos sillesh me arrogance , dhe nëse arrin të kesh një raport të mire me Allahun, dije se ke në dorë çelesat e mbarëvajtjes së çdo gjëje që ndodh në jetën tande.

Le t'i lutemi Allahut për një besim të sinqertë dhe të palëkundur gjatë tërë jetës sonë. Amin!

DREJT NJË LIDHJEJE MË TË FORTË ME KUR'ANIN

Durim Kasemi,
Imam - xhamia Parrucë

Brezat e parë të muslimanëve kanë qenë dhe do të mbeten përherë gjeneratat më të mira dhe njerëzit më të përkushtuar në fenë e Allahut. Kuptimi që ata kanë pasur për fenë, mbetet më i sakti deri në kijamet.

Thëniet e tyre të përcjella tek ne, e tregojnë më së miri këtë gjë. Ato rrezatojnë devotshmëri, frikë ndaj Zotit, respektim dhe nderim ndaj fesë së tij dhe kuptim të saktë e të drejtë të mesazheve hyjnore.

Po i them këto fjalë sepse një mik i imi, një ditë ndau me mua disa thënie dijetarësh nga gjeneratat e para - me ndonjë përjashtim të ndonjë dijetari të mëvonshëm - të Islamit rreth Kuranit Famëlartë të cilat thonë shumë, edhe pse të shkurtra për nga fjalët dhe fjalitë që i përbënin ato. Më pëlqyen shumë dhe kisha dëshirë ti ndaja edhe me ju, me shpresën që do të prekin zemrën e dikujt për të forcuar lidhjen e tij me Kur'anin Famëlartë, në këtë kohë ku lidhja jonë me Kur'anin është dobësuar përpara tundimit tejet të madh të pajisjeve elektronike "smartfonëve"dhe gjërave të tjera.

Sufjan Eth-Theuri ka thënë: "Ah, sikur te isha angazhuar vetëm me Kur'anin".[1]

Kjo është fjala e Sufjan Eth-Theuriut, i cili ka qenë ndër dijetarët më të mëdhenj të hadithit dhe nuk është marrë me ndonjë gjë të rëndomtë por me hadithin e Pejgamberit (a.s), por përsëri në një moment të jetës së tij shpreh dëshirën, që të ishte marrë vetëm me Kur'an. Po ne që merremi më së shumti me gjëra që nuk i afrohen për nga vlera dhe rëndësia Hadithit të Pejgamberit, çfarë mund të themi në lidhje me raportin tonë me Kur'anin?

Këtë e kam dëgjuar edhe nga njëri prej dijetarëve më të mëdhenj të hadithit në kohën tonë, Ebu Is'hak El-Huvejni kur e pyetën se çfarë do të kishe ndryshuar në jetën e tij? Ai i tha: Do të isha angazhuar vetëm me Librin e Allahut, Kur'anin dhe me asgjë tjetër.

Ka thënë Ibn Tejmije: "Jam bërë pishman që e kam shpenzuar shumicën e kohës time duke u marrë me diçka tjetër, e jo me kuptimin dhe interpretimin e Kur'anit".

A dini se kush është Ibn Tejmija dhe se si e ka shpenzuar kohën ai?

Në facebook, jo! Internet, jo! Filma jo! Ibn Tejmija gjithë jetën e tij e ka kaluar në vetëm katër gjëra: Duke zënë dije, duke ua mësuar atë të tjerëve, duke ftuar të tjerët në fenë e Allahut dhe duke shkruar libra rreth fesë së Allahut.

Dhe a e dini se sa është numri i titujve që ka shkruar Ibn Tejmija?! 298 tituj! Kushdo që i lexon librat e tij kupton se dija e tij ka qenë Kur'an dhe Sunet, por Ibn Tejmija përsëri është bërë pishman se nuk i është përkushtuar më shumë kuptimit dhe meditimit të Kur'anit .

Çfarë duhet të themi ne, lexues i dashur, kur IbnTejmija thotë kështu?! Asgjë tjetër vetëm se t'i kërkojmë Allahut falje për lidhjen e dobët që kemi me Kur'anin dhe ta lusim Atë të na e forcojë lidhjen, e të rinisim një kapitull të ri në marrëdhënien tonë me Kur'anin.

Ka thënë Sufjan ibn Ujejneh: "Pasha Allahun, nuk do të arrini majat e kësaj feje derisa fjala e Zotit të jetë më e dashur për ju se çdo gjë tjetër, sepse kush e do Kur'anin, ai e do Allahun, kuptojeni atë që po ju them".

Ahmed ibn Ebi El-Huvara ka thënë: "Lexoj Kur'anin ajet për ajet dhe gati sa s'më ikën mendja dhe çuditem me hafizat e Kur'anit se si e shijojnë gjumin ata. Si u shijon të merren me diçka tjetër në dynja kur ata flasin me fjalën e Allahut. Por, sikur ta kuptonin atë që lexojnë, e ta njihnin atë siç duhet, ta shijonin atë, të ndjenin ëmbëlsinë e të drejtuarit Allahut me Kur'an, atyre do u kishte ikur gjumi nga gëzimi se çfarë rrizku u ka dhënë Allahu".

Ka thënë Ebu Umame El-Bahili: "Lexojeni Kur'anin dhe mos t'ju mashtrojnë mus'hafet e Kur'anit të varur, sepse Allahu nuk e ndëshkon një zemër, e cila e bart Kur'anin".

Sikur Ebu Umame të jetë prezent në kohën tonë, ku pothuajse çdo shtëpi ka Kur'an, por vetëm se mbahet i varur në ndonjë vend apo i vendosur në ndonjë raft, çfarë do të kishte thënë?! Kur'ani duhet lexuar sepse ndryshe nuk ka dobi. Bereqeti dhe mirësia e tij vjen kur ai lexohet, mësohet e praktikohet dhe jo kur varet apo lihet në një vend të caktuar.

Ka thënë Abdullah ibn Mes'udi: "Nëse kërkoni dituri, atëherë studiojeni Kur'anin në mënyrë shteruese , sepse në të është dituria e të parëve dhe e atyre që do vijnë më pas".

Ka thënë Ebu Hurejra: "Shtëpia në të cilën lexohet Kur'ani, bëhet e rehatshme për banuesit e saj, i shtohet bereqeti dhe në të qëndrojnë melekë, dhe shejtanët largohen prej saj. Ndërsa shtëpia në të cilën nuk lexohet Kuran, nuk është e rehatshme për banorët e saj, në të ka pak mirësi dhe në të hyn shejtanët dhe dalin melekët".

Këshillë që shkruhet me germa të arta për një shtëpi të mbushur me mirësi në të gjitha aspektet. Aty ku lexohet fjala e Allahut zbret çdo e mirë dhe aty ku ajo mungon, mungon çdo e mirë. Mirësia e fjalës së Krijuesit të gjithësisë tejkalon çdo gjë dhe depërton tek çdo gjë. Dëshiron që shtëpia jote të ketë bereqet, hajr dhe mirësi? Atëherë lexo sa më shumë Kur'an në të.

Hasan ibn Ali ka thënë: "Ata që ishin para jush e kanë shikuar Kur'anin si mesazhe nga Zoti i tyre, prandaj ata meditonin në Kur'an gjatë natës, kurse gjatë ditës e ndjenin mungesën e tyre".

Kjo është një thirrje për të rifreskuar vështrimin tonë rreth Kur'anit, i cili ndikon drejtpërdrejt tek raporti jonë me të. Muslimanët e parë e kishin bindje të prerë në mendjet dhe zemrat e tyre se ky Kur'an është mesazh nga Allahu drejtuar tek secili prej tyre, prandaj dhe e trajtonin atë me seriozitetin që duhet marrë një letër a mesazh nga Krijuesi i gjithësi, dhe jo një libër dosido i dërguar nga dikush.

Othman ibn Affani ka thënë: "Sikur zemrat tona të ishin të pastra nga gjynahet, nuk do ishin ngopur me leximin e Kur'anit".

Në shumë ajete në Kur'an, Allahu na tregon se Kur'ani është shërim për zemrat, por ndodh që shpesh herë të lexohet, e të mos ndikojë tek zemrat tona! Përgjigjen për këtë na e jep thënia e Othamit, i cili na tregon se pengesa dhe problemi i mos ndikimit të Kur'anit në zemrat tona nuk është tek ai, por tek vetë ne, tek papastërtitë e gjynaheve që kanë katranosur zemrën dhe nuk lejojnë depërtimin e rrezeve të dritës së Kur'anit tek dritaret e saj. Prandaj, pastro zemrën nga mbetjet e gjynaheve që të shijosh Kur'anin dhe lejo dritën e tij të depërtojë në zemrën tënde.

Ibn Mes'udi ka thënë: "Mos e lexoni Kur'anin shpejt siç lexohet poezia..., ndaluni dhe meditoni mrekullitë e tij dhe bëjeni atë që t'u prek zemrat tuaja, e mos të jetë qëllimi juaj, arritja e fundit të sures".

Qëllimi final i leximit të Kur'anit nuk është thjeshtë leximi i tij, por leximi dhe të ndikuarit nga ai. Nisur nga kjo, leximi sa për të arritur në fund të sures apo xhyzit (një pjese), nuk bën edhe aq dobi dhe nuk përmbush qëllimin e vetë leximit të Kur'anit. Një njeri pyeti Ibn Abbasin: Unë e lexoj shpejt Kur'anin, saqë bëj një hatme në tre ditë. Ibn Abbasi i tha: Të lexoj suren Bekare në një natë dhe të meditoj në të e ta kuptoj, është më e dashur për mua se sa ajo që bën ti.

Kanë thënë: "Sa herë qe shtoja pjesën që ia kisha caktuar vetes për ta lexuar brenda ditës, aq më shumë më shtohej bereqeti në kohën time dhe kështu vazhdova t'i shtoj pjesët e Kur'anit derisa kam arritur në dhjetë xhyze (pjesë) në ditë".

Kur'ani sjell bereqet kudo që zë vend dhe çdo gjë që mbush. Këtu nuk bën përjashtim as koha e njeriut. Nëse njeriu e mbush një pjesë të e kohës së tij me leximin e Kur'anit, e gjithë pjesa tjetër do të kaplohet nga bereqeti. Muaji në të cilin ka zbritur Kur'ani, është bërë muaji më i madhërishëm me zbritjen e Kur'anit në të. Po jeta e njeriut, si do të bëhej nëse Kur'ani do të ishte pjesë e pandashme e saj. Bëje Kur'anin pjesë të jetës tënde, qoftë edhe me një pjesë shumë të vogël, sepse puna më e dashur tek Allahu është ajo e vazhdueshmja, edhe pse mund të jetë e vogël.

Ka thënë Abdullah ibn Mesudi: "Zemrat janë si enë, prandaj mbushni ato me Kur'an dhe jo me ndonjë gjë tjetër".

Në kohën që jetojmë gjërat mashtruese të zemrës dhe të mendjes janë të shumta, dhe kam bindjen se nuk kanë qenë asnjëherë më shumë sesa sot. Të gjitha pa përjashtim, ku nga jashtë duken si argëtuese dhe që ngjallin hare e gëzim, në realitet nuk janë, vetëm se mbytëse dhe munduese për zemrën e mendjen. Kurani është ilaçi i vetëm i të gjitha këtyre sëmundjeve vrasëse të zemrave dhe qetësisë së tyre prandaj, mbushja e zemrës me Kur'an është rruga më e mirë për të gjetur qetësinë e humbur.

1. Nuk kam përmendur burimet për të mos e tretur vëmendjen e lexuesit si dhe për arsyen se këto thënie janë të njohura dhe të përhapura në pothuajse të gjithë librat burimorë të hadithit dhe në jetëshkrimet e dijetarëve që i kanë thënë.

NJË GRUP BESIMTARËSH SHKODRANË VIZITOJNË KUDSI SHERIFIN

Ditën e enjte, më 17 janar 2019, një grup besimtarësh shkodranë, nën drejtimin e teologut Naim Drijaj, imam i xhamisë Parrucë, u nisën për të vizituar Kudsi Sherifin, ku ndodhet edhe xhamia Aksa, e treta e vendeve të shenjta islame.

Grupi i vizitorëve të Aksasë u pritën edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili i uroi me rastin e kësaj vizite historike.

Myftiu foli mbi vlerën e këtij vendi dhe stacioneve të ndryshme, nëpër të cilat ia vlen të ndalesh e të përkujtosh një histori shekullore të mbushur me gjurmë pejgamberësh, ngjarjesh të shenjta e lutjesh të shumta që mbushin atë atmosferë të bekuar.

Sipas kontakteve, grupi i besimtarëve shkodranë kanë mbërritur shëndosh e mirë në Kudsi Sherifë dhe sot do të falin namazin e xhumasë në xhaminë e shenjtë të Aksasë.

UDHA ISLAME

KUDSI SHERIF,

TAKIM ME VIZITORËT E VENDIT TË SHENJTË

Pasditën e së enjtes, më 24 janar 2019, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet me rastin e kthimit në vendlindje të grupit të besimtarëve shkodranë, që vizituan para pak ditësh vendin e shenjtë të Kudsi Sherifit dhe xhaminë Aksa.

Aktiviteti u hap me fjalën e rastit të mbajtur nga teologu Arben Halluni dhe u fokusua tek mbresat dhe kujtimet e paharruara, që u përmblodhën me shumë emocion nga teologu Naim Drijaj, imam i xhamisë Parrucë.

Gjatë fjalës së tij, imami i nderuar foli për shenjtërinë e Kudsi Sherifit, si dhe pozitën e këtij qyteti me stacionet e tij historike në jetën e muslimanëve.

Ai paraqiti para të pranishëmve disa prej vendeve dhe autoriteteve të larta, që vizituan gjatë qëndrimit në Jeruzalem dhe Betlehem.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, i cili falënderoi zv/ambasadorin e Palestinës në vendin tonë, SHTZ. Hani Husejn për gatishmërinë për të ndihmuar vizitorët shkodranë, të cilët u pritën me shumë nderime dhe respekt nga vëllezërit e tyre në Palestinë.

Njëkohësisht përhajroi grupin e vizitorëve për këtë mirësi të madhe dhe uroi që numri i shkodranëve që vizitojnë këtë vend të shenjtë të shtohet.

Me shumë interes u ndoq edhe fjala e rastit nga zv/ambasadori palestinez në vendin tonë, SHTZ. Hani Husejn, i cili përcolli mesazhet e tij të ngrohta për të pranishmit dhe vizitorët e Kudsi Sherifit në veçanti.

Ai tha se historia e Shkodrës me Kudsin e shenjtë lidhet prej shekujsh, edhe për faktin se shumë ushtarë shkodranë kanë luftuar për mbrojtjen e kësaj toke të shenjtë, gjatë shekullit të kaluar. Sikurse përmendi se emrat dhe flamuri i tyre ruhen sot në muzeun historik të Kudsi Sherifit.

Aktivitetin e përshëndeti edhe H. Fejzi Zaganjori, që bëri edhe një lutje për popullin martir palestinez, sikurse përshëndeti edhe z. Muamer Vuci, Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Vendet Arabe.

Aktiviteti u shoqërua nga përshëndetje dhe urime të përzemërta në mesin e të pranishëmve.

SIRIA NË EPOKËN ISLAME, SI DIELLI RREZATUES I MIRËSISË DHE I DITURISË (2)

Në vargun e këtyre njerëzve të mëdhenj, ne si shqiptarë kemi nderin të përmendim edhe disa dijetarë të shquar të Islamit me origjinë nga vendi ynë, nga Shqipëria. Ata janë, Muhamed Nasirudin El-Albani, Vehbi Sulejman Gavoçi, Abdulkadir Arnauti, Shuajb Arnauti, etj.

MUHAMED NASIRUDDIN ALBANI (1914 - 1999)

Muhamed Nasiruddin ibn Nuh Nexhati El-Albani, ose ndryshe "Muhamedi, ndihmësi i fesë, djali i Nuh Nexhatit, shqiptari", lindi në qytetin e Shkodrës, në vitin 1914, në një familje fetare. Babai i tij, haxhi Nuh Nexhati kishte studiuar në Stamboll dhe në Shkodër kishte punuar më vonë si imam. Si pasojë e trazirave që po përjetonte Shqipëria, Haxhi Nuhu u largua nga Shkodra bashkë me familjen e tij, dhe mori rrugën për në Sham, në Siri, më qëllimin për të bërë një jetë fetare islame.

Shejkh Albani u rrit dhe u brumos në Damask, dhe aty i mori mësimet e tij të para. Pasi përfundoi arsimin e tij të hershëm, ai iu nënshtrua një pune rigoroze në fushën e studimeve arabe dhe islame, pranë dijetarëve të shquar të asaj kohe. Ndërkohë, ai punonte si orëndreqës, për të ndihmuar familjen e tij.

Që nga vitet 1930 dhe deri rreth moshës 20 vjeçare, Shejkh Albani filloi të specializohet në shkencën e Hadithit dhe tema të lidhura me të. Ai shquhej për "xhelozinë" ndaj traditës Profetike dhe për dashurinë e madhe për të. Punoi me shumë kujdes për ngritjen dhe ruajtjen të pastër të saj prej çfarëdo shtojce.

Ai transkriptoi dhe komentoi tekstin monumental të shkruar nga El-Hafidh El-Iraki: "El-Mugni an hamlil esfar", pasuar nga një sërë librash të tjerë e leksionesh, si dhe artikujsh me ndikim në revistën El-Manar. Ai shkroi dhe redaktoi më shumë se 300 libra dhe dorëshkrime, shumë prej të cilëve u bënë referencat kryesore për studiuesit e hadithit.

Shejkh Albani vizitoi dhe ligjëroi në disa vende arabe dhe evropiane, përfshirë: Katarin, Kuvajtin, Egjiptin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Spanjën, Britaninë, Marokun dhe Gjermaninë. Ai gjithashtu dha mësim në lëndën "Shkencat e Hadithit" në Universitetin Islamik të Madines, në Arabinë Saudite, për tre vjet. Botimet e tij me influencë dhe mësimet e ligjëratat e tij të ndjekura gjerësisht gjatë një periudhe prej 60 vjetësh, kanë pasur një ndikim të rëndësishëm, jo vetëm në fushën e Hadithit, por edhe në degët e tjera të studimeve bashkëkohore islame.

Edhe pse Shejkhu u distancua nga aktivitetet politike, ai u sulmua disa herë dhe u arrestua dy herë, në një hapësirë kohore prej 9 muajsh. Gjatë kohës që ai ishte në burg, redaktoi veprën "Muhtasar Sahih Muslim" të Hafiz Mundhiriut. Ai u largua nga Siria për në Jordani përfundimisht dhe atje i kaloi vitet e fundit të jetës së tij.

Shejh Albani ndërroi jetë në vitin 1999, në moshën 89 vjeçare (Allahu e mëshiroftë!).

Ai la pas një sërë veprash, nga të cilat më të njohurat janë "Es-Selsele Es-Sahiha" (Zinxhiri i saktë), "Es-Selsele Ed-Daife" (Zinxhiri i dobët) dhe "Irva' El-Galil".

SHEJKH VEHBI SULEJMAN GAVOÇI - (1923 - 2013)

Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi, lindi në Shkodër në vitin 1923 në një familje fetare, ku i ati, Sulejman Gavoçi, ishte një nga dijetarët islam të kohës.

Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi, shkollën fillore e mbaroi në Shkodër, por nuk e vazhdoi më tej shkollimin atje, për shkak të natyrës jo islame që po merrte arsimi në Shqipëri asokohe nën drejtimin e Ahmed Zogut.

Në vitin 1939, familja e tij emigruan për në tokat e bekuara të Sirisë, dhe u vendosën në Damask. Po atë vit, i ati e dërgon në Egjipt për të ndjekur studimet fetare islame, në shkollën e famshme të Az'harit Sherif. Atje ai qëndroi rreth dhjetë vite ku mbaroi me sukses Fakultetin e Sheriatit Islam, të ndjekur edhe nga dy vite studime specializimi në fushën e Gjyqësorit, dhe mori diplomën Ndërkombëtare të Az'harit, e cila ishte e barazvlefshme me shkollën e doktoraturës në ditët e sotme. Studimet atje i përfundoi në vitin 1947.

Pas kthimit nga Egjipti, ai filloi aktivitetin e tij si mësues i lëndëve fetare në Haleb (Aleppo) të Sirisë, dhe pas tri vjetësh u transferua në Damask, ku qëndroi deri në vitin 1965, kohë gjatë së cilës punoi edhe si ligjërues në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin e Damaskut. Në vitin 1966 udhëtoi për në Arabinë Saudite, ku punoi si profesor për pesë vite rresht, pastaj u kthye sërish në Damask.

Më vonë, mes viteve 1986-2001, ai punoi si pedagog në Universitetin e Studimeve Arabe dhe Islame në Emiratet e Bashkuara. Pastaj u kthye sërish në Damask, ku vazhdoi punën e tij si mësues i Jurisprudencës Islame në Institutin El-Fet'h El-Islami atje.

Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi njihej për natyrën e tij të mirë, moralin e tij të lartë, për dashurinë e madhe të tij për diturinë islame dhe përhapjen e saj ndër njerëz me dashuri dhe mirësi.

Ai shkroi shumë libra, ku vetëm në gjuhën arabe realizoi rreth dyzet të tillë, në fushat e jurisprudencës islame, në akide, rreth vlerave dhe përfitimeve të Kur'anit, biografi dijetarësh, biografinë e të Dërguarit të Allahut (a.s), ku libri i tij i fundit ishte "Muhammed Resulullah". Ndërsa në gjuhën shqipe shkroi rreth njëzet e tre libra, për çështje të ndryshme fetare.

Ai gjithashtu bashkëpunoi në hartimin e librave shkollorë në Ministrinë e Vakëfeve të Sirisë, shkroi shumë artikuj në revista dhe gazeta të ndryshme, si në revistat El-Menar dhe Ed-Dija', dhe ligjëroi në xhaminë e shqiptarëve të ngritur nga babai i tij i nderuar, në Damask, si dhe mbante ligjërata fetare në shumë xhami të tjera të qytetit.

Sipas dëshmisë së vetë Shejkhut, ai kishte pasur gjithnjë dëshirë të madhe ta vizitonte Shqipërinë, por nuk ishte lejuar, dhe kështu ai kishte vizituar trojet shqiptare jashtë Shqipërisë, si Kosovën dhe Maqedoninë, duke mbajtur atje ligjërata fetare. Pastaj, pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri, pas viteve 1991, ai menjëherë erdhi në atdhe dhe vizitoi vendin e tij të lindjes, Shkodrën, duke mbajtur ligjërata fetare në shumë xhami të qytetit dhe duke shpërndarë literaturë islame. Një ndër librat e tij më të spikatur të botuar në Shkodër është libri "Mëshira e dhurueme tansisë (a.s.s)", një jetëshkrim për të Dërguarin e Allahut (a.s).

Hoxha i nderuar, Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi, ndërroi jetë më 19 Shkurt të vitit 2013, në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe, në moshën 90 vjeçare, pas një jetë të mbushur me mirësi dhe me punë të palodhur në shërbim të fesë së Zotit. Allahu e mëshiroftë dhe e banoftë në xhenetet e tij të gjëra, dhe i shtoftë në tokë njerëzit si ai!

ABDULKADIR ARNAUTI (1928 - 2004)

Thirrësi islam dhe shqiptari që u rrit dhe veproi në Siri, Abdulkadir Arnauti, u lind në vitin 1928, në Kosovë. Ai emigroi bashkë me familjen qëkur ishte i vogël, dhe u vendosën në Damask të Sirisë. Atje ai mori mësimet e para. Pastaj më vonë e zgjeroi interesin e tij në shkencat e Kur'anit dhe të Hadithit. Shejkh Abdulkadir Arnauti iu përkushtua pastaj më së shumti shkencës së Hadithit, dhe shkëlqeu në të.

Ao, përveç gjuhës arabe, fliste edhe gjuhën shqipe, e njihte edhe pak nga frëngjishtja.

Më vonë punoi si mësues i shkencës së Kur'anit dhe të Hadithit, mes viteve 1952- 1959, në shkollën "El Is'af El-Hajrij", në të cilën kishte mësuar edhe vetë. Pastaj vazhdoi të angazhohej si thirrës islam dhe mësues i lëndëve fetare në Institutin Arab Islam, e në institute të tjera islame. Punoi gjithashtu edhe si ligjërues-hatib në disa nga xhamitë e qytetit të Damaskut. Ai punoi edhe në Bibliotekën Islame, në Damask të themeluar nga Shejkh Zuhejr Shavish, ku doli në pah aftësia e tij si hulumtues i trashëgimisë së dijetarëve të hershëm, bashkë me një grup dijetarësh të tjerë të kohës, përfshirë edhe Shejkh Nasiruddin Albani.

Shejkh Abdulkadir Arnauti ka vizituar disa herë Kosovën, vendin e tij të lindjes, dhe ka dhënë një ndihmë të madhe për përhapjen e diturisë fetare atje.

Doktoranti i shquar i botës arabe Vehbi Zuhejli thotë për Shejkh Abdulkadir Arnautin: "Shejkh Abdulkadri karakterizohet për pastërtinë dhe saktësinë e të folurit të gjuhës arabe, për forcën e memories, për devotshmërinë e tij, për dashurinë që njerëzit kanë ndaj tij, për njohuritë e tij të dispozitave të hallallit dhe të haramit, për njohjen e thellë të shkencës së Hadithit, për moralin e tij të lartë... Ai i respekton dijetarët, u rri pranë atyre dhe i rrinë pranë edhe ata duke gjetur tek njëri-tjetri dashurinë për Sunetin Profetik dhe kujdesin për të. Bota dëshmoi nga ai shkrime e autorësi, dhe hulumtime shkencore të shumta dhe të imtësishme, të mira e të shkëlqyera."

Për jetën dhe veprën e Shejkh Abdulkadir Arnautit është shkruar edhe një tezë universitare me titull: "Zbulimi i perdes prej njërit nga dijetarët e hadithit të Shamit, Shejkh Abdulkadir Arnautit".

Abdulkadir Arnauti mendonte se hulumtimet shkencore në veprat e dijetarëve të hershëm janë më të vlefshme sesa punimet e reja, kjo për shkak të numrit të madh të punimeve e librave të pranishëm. Ai ka hulumtuar dhe saktësuar më shumë se pesëdhjetë vepra. Pas një jete të frytshme, me lejen e Allahut, Shejkh Abdulkadir Arnauti ndërroi jetë më 26 nëntor, në vitin 2004, në Damask. Allahu e mëshiroftë dhe e banoftë në gjerësinë e xheneteve të Tij!

SHUAJB ARNAUTI - (1928 - 2016)

Dijetari hulumtues, Shuajb Arnauti, lindi në Damask të Sirisë në vitin 1928. Ai rrjedh nga një familje shqiptare, shkodrane, që kishin emigruar drejt tokave të bekuara të Shamit, dhe ishin vendosur në Siri, në vitin 1926. Që në moshë të njomë, ai u brumos me ndjenjën fetare, nën kujdesin e dy prindërve të tij shqiptarë. Babai i tij ishte një njeri i ditur. Qysh në vogëli, Shuajb Arnaut, ishte i dhënë pas studimit të gjuhës arabe. Ai frekuentoi dijetarët më të shquar të kohës, në xhamitë dhe në shkollat e Damaskut, për të marrë sa më shumë njohuri në shkencën e gjuhës, në të gjitha degët e saj. Gjithashtu ndoqi mësime në fushën e "Parimeve Islame", si dhe mësoi shumë pjesë nga Kur'ani Famëlartë.

Pasi i kreu studimet në shkencën e gjuhës arabe, ai iu përkushtua plotësisht studimit të shkencave islame, si Jurisprudencën Islame, sidomos medhhebin Hanefi, përveç studimeve të tij në fushën e Komentimit të Kur'anit dhe në fushën e Hadithit të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Gjatë studimeve në këtë fushë, ai vërejti nevojën e madhe për kërkime të thelluara në shkencat islame.

Në vitin 1955 ai filloi të punonte si mësues i gjuhës arabe, por më vonë e la atë profesion, për t'iu përkushtuar krejtësisht studimit të trashëgimisë së Shkencave Islame. Këtë mision ai e filloi në Damask, në vitin 1958, ku kryesoi departamentin e hulumtimit dhe të saktësimit, për një periudhë 20 vjeçare. Ai hulumtoi dhe saktësoi më shumë se shtatëdhjetë vëllime nga librat themelor të trashëgimisë së Shkencave Islame. Këtë mision të tij më vonë ai do ta vazhdonte në Fondacionin Er-Risale, në Amman të Jordanisë.

Nga punët e tij më të spikatura mund të përmendim veprën "Sherhus-Sunneh" të Bagaviut, të përbërë nga 16 vëllime, "Raudatut-Talibin" të Imam Neveviut, punë që e bëri bashkë me dijetarin islam shqiptar, Abdulkadir Arnautin, dhe që përfshinte 12 vëllime, "Muhedhdheb El-Egani" të Ibn Mendhurit, me 12 vëllime, "Sijer E'lam En-Nubela" me 25 vëllime, e shumë tituj të tjerë.

Dijetari Shuajb Arnauti ishte gjithashtu një profesor, nga duart e të cilët dolën dijetarë të tjerë të shquar të botës Islame.

Megjithëse lindi dhe u rrit në tokat e Shamit, Shejkh Shuajbi asnjëherë nuk e harroi origjinën e tij dhe me krenari e deklaronte se ishte shqiptar. Ai e fliste shumë mirë gjuhën shqipe. Studentët shqiptarë që patën fatin të shkojnë në tokat e bekuara të Shamit për studime, pas rrëzimit të komunizmit në vendin tonë, gjetën tek Shejkh Shuajbi mbështetje të fortë dhe inkurajim për në rrugën e dijes islame.

Shejkh Shuajb Arnauti ndërroi jetë, me 27 tetor, të vitit 2016, pas një jete të mbushur me punë të nderuar, në shërbim të fesë së Zotit.

Ai tashmë kujtohet si "Shërbëtori i Traditës Profetike" dhe si një "Dijetar i shquar i Hadithit Profetik". Allahu e shpërbleftë me xhenetet e Tij!

***

Këta që përmendëm ishin vetëm disa nga dijetarët që toka e bekuar e Sirisë i lindi, i rriti apo i mbajti në gjirin e saj, por vargun e plotë të dijetarëve të atij vendi do të duheshin vepra me shumë vëllime për të shkruar për ta.

***

Tani këto vitet e fundit toka e Sirisë po kalon ditë të vështira.

Allahun e madhërishëm e lusim që sa më shpejt paqja të mbretërojë në gjithë tokat e Shamit, dhe ato vise të vazhdojnë të shkëlqejnë e të rrezatojnë dituri e mirësi, ashtu siç patën shkëlqyer ndër shekuj.

O Zot, derdh mëshirën Tënde në tokat e Shamit, dhe bekoji përsëri, madje edhe më shumë sesa i ke pasë bekuar dikur më parë! Amin!

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

Burimet e përdorura:

Libri "Teraxhim Ulema' esh Sham ue men nezele ou sekene biha"

http://www.aljazeera.net/encyclopedia

http://www.odabasham.net

https://kingfaisalprize.org/sheikh-mohammad-nasir-ad-din-al-albani/

XHAMIA AKSA - AMANETI I MUSLIMANËVE

Naim Drijaj,
Imam - xhamia Parrucë

Të flasësh për xhaminë Aksa dhe për qytetin e Kudsit, është një privilegj dhe kënaqësi e madhe. Si xhamia Aksa ashtu edhe Kudsi (Jeruzalemi) duhet të përjetësohen në memorien e çdo muslimani. Ato duhet të bëhen edhe objekt bisedash mes prindërve dhe fëmijëve të tyre sepse Kudsi dhe xhamia Aksa janë vende të shenjta për çdo musliman.

Ne nuk duhet të harrojmë se xhamia Aksa zë një vend të rëndësishëm në Islam. Ajo është xhami e dashur për vetë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Ajo është xhamia nga drejtoheshin muslimanët për t'u falur në fillimet e fesë. Ajo është xhamia e tretë e shenjtë për muslimanët, pas Qabes dhe xhamisë së Profetit (a.s). Ajo është xhamia drejt së cilës udhëtoi Muhamed (a.s) natën e Israsë. Nga aty ai u ngjit në udhëtimin e Miraxhit. Ajo është xhami, emri i së cilës ceket në Kur'an dhe shoqërohet me epitetin "e bekuar".

Toka e Palestinës është djepi i shumë profetëve, është dëshmitare e shpalljeve hyjnore të zbritura nga Allahu gjatë historisë. Në dheun e kësaj toke kanë shkelur pejgamberët e Allahut: Hazreti Ibrahimi, Luti, Ismaili, Is'haku, Ja'kubi, Musai, Davudi, Sulejmani, Iljasi, Jahjai, Zekerija, Isai e shumë të tjerë (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta). Gjithashtu, në këtë tokë të shenjtë jetuan dhe u varrosën shumë nga shokët e Profetit Muhammed (a.s).

Kudsi, Jeruzalemi, është matësi i besimit dhe i sigurisë në tokë. Nëse Kudsi është i stabilizuar dhe i qetë, e gjithë bota është e tillë. Nëse është i trazuar, e gjithë bota përfshihet nga trazirat.

Sot, Kudsi Sherifë thërret me madhështinë e tij mbarë ymetin islam, për t'u solidarizuar me të, për t'u lutur bashkërisht, për paqen, për harmoninë, për drejtësinë, për besimin, për lirinë, për të ardhmen!

Në Kur'anin Famëlartë, teksa lexojmë fillimin e sures El-Isra, kuptojmë edhe më shumë për madhështinë dhe shenjtërinë që i ka dhënë Allahu Fuqiplotë, Xhamisë Aksa dhe Kudsi Sherifit në përgjithësi: "I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhammedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jerusalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona."[1]

1- Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Mos udhëtoni (me qëllim adhurimi), përveçse në tri xhami: Për në Qabe, për tek xhamia ime dhe për tek xhamia Aksa."[2] Të gjithë dijetarët islam janë të mendimit se është e pëlqyeshme vizita e xhamisë Aksa për të kryer adhurimet islame si: Namaz, i'tikaf etj.

Sipas statistikave në vitin 2015 Kudsi Sherifin e kanë vizituar 600.000 Amerikan, 400.000 Rus, 300.000 Francez dhe ndër vendet muslimane ata që e kanë vizituar më shumë Kudsin janë turqit. Numri i vizitorëve turq është 26.000.[3]

2- Xhamia Aksa është faltorja e dytë, e ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës.

Ebu Dherri (r.a) e ka pyetur Profetin Muhammed (a.s) se cila është xhamia e parë e ndërtuar në tokë? Profeti (a.s) i është përgjigjur: "Mesxhidul-Haram (Xhamia e Shenjtë e Qabes)." Po pastaj cila xhami? Ka pyetur Ebu Dherri. "Xhamia Aksa (Xhamia e Largët)" - tha Profeti (a.s). Sa vite më pas është ndërtuar Xhamia El-Aksa?" - pyeti përsëri Ebu Dherri. "40 vite" u përgjigj ai Zotëri (a.s).[4]

3- Xhamia Aksa ka qenë Kibla e parë, drejtimi gjatë faljes i të gjithë muslimanëve.

Berra ibn Azib (r.a) ka thënë: "Jemi falur me të Dërguarin e Allahut drejt xhamisë Aksa për 16-17 muaj. Pastaj e kthyem drejtimin nga Qabja".[5] Pejgamberi Muhammed (a.s) edhe pas emigrimit të tij në Medine, ka falur namazin në drejtim të Kudsit për 16-17 muaj (Afërsisht një vit e gjysëm).

4- Xhamia Aksa është toka, ku profeti Muhammed (a.s) realizoi udhëtimin e Israsë dhe prej andej u ngjit në qiell, gjatë udhëtimit të Miraxhit. Gjatë Israsë, Profeti (a.s) udhëtoi i shoqëruar nga meleku Xhebrail (a.s) prej Mekës në Misxhidul-Aksa dhe që andej në sferat e larta qiellore.

Udhëtimi për në qiell mund të bëhej direkt nga Meka, por jo pa qëllim kalimi u bë pikërisht nëpër këtë stacion të shenjtë. Ky udhëtim i dha misionit të Profetit Muhammed (a.s) një përmasë tjetër dhe e lidhi atë me vargun e gjatë të profetëve. Në xhaminë Aksa, atë natë, janë tubuar të gjithë të dërguarit e Allahut dhe kanë falur namaz nën drejtimin e Profetit (a.s).

Qëllimi kryesor i këtij tubimi, si asnjëherë më parë, ishte shenjë e vazhdimësisë së Tevhidit (Njësimit), i cili ka qenë mesazhi i të gjithë profetëve dhe njëherazi, dorëzimi i udhëheqjes fetare në duart e Profetit të fundit, pasardhësit të Ismailit, për të dëshmuar se ai që do të ishte përgjegjës për xhaminë Aksa, tashmë ishte Muhammedi (a.s).

5- Pejgamberi (a.s) na tregon se vlera e një namazi në këtë xhami ka vlerën e 250 namazeve në xhamitë e tjera. "Një namaz në xhaminë time është më i mirë se katër namaze në të (Bejtul-Makdis)."[6] Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Një namaz në Mesxhidi Haram ka vlerën e njëqind mijë namazeve, ndërsa një namaz në xhaminë time ka vlerën e njëmijë namazeve, ndërsa një namaz në Bejti Makdis ka vlerën e pesëqind namazeve"[7]

Ditën e mërkurë, më 16 janar 2019, një grup besimtarësh shkodranë të përbërë nga:

1. Besnik Elbasani
2. Fatmir Dilaveri
3. Agim Et'hemi
4. Ridvan Raboshta
5. Ermir Fikaj
6. Dritan Boshnjaku
7. Fatjon Tula
8. Naim Drijaj,

Ky grup u nis për të vizituar Kudsi Sherifin, ku ndodhet edhe xhamia Aksa, e treta e vendeve të shenjta islame.

Dita e parë:

Me datë 17.01.2019 mbërritëm në aeroportin "Ben Gurion" në orën 9 të mëngjesit. Pasi zbritëm nga avioni, u drejtuam drejt sportelit të kontrollit, ku normalisht shqiptarët kalojnë pa viza.

Megjithatë, nga grupi jonë u ndaluan katër persona ku ndër ta isha edhe unë.

1. Kur'ani, El-Isra: 1.
2. Buhariu.
3. https://www.youtube.com/watch?v=1BrLhvm7_KO&t=1289s
4. Buhariu.
5. Buhariu dhe Muslimi.
6. Hakim.
7. Tabarani.

Tre personat e tjerë u morën në pyetje më pak në krahasim me mua. Tek sporteli më pyetën se si quhej babai im dhe cilës fe i përkisja. Pasi i tregova që babai im quhet Sulltan dhe jam musliman më tha që të shkoja tek një dhomë, që ishte dhoma e pritjes. Pas një çerek ore pritjeje më erdhi një person, më mori dhe më dërgoi në një dhomë tjetër ku më pyetën se përse kisha ardhur në atë vend. Gjithashtu më pyetën në lidhje me profesionin tim dhe cilat vende do të vizitoja. Pastaj më dërguan tek një dhomë tjetër ku më pyetën përafërsisht të njëjtat pyetje dhe kjo situatë e sikletshme zgjati një orë e gjysëm!? Pas një orë e gjysëm pritjeje e kalova sportelin e kontrollit dhe u bashkova me grupin, i cili po më priste.

Në aeroport u pritëm nga Ahmed Ahmed (Përgjegjës i Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë e Jeruzalemit) i cili na ofroi një bisedë të veçantë si dashamirës i yni.

Rruga për në hotel ishte mbresëlënëse nga bukuritë që pamë gjatë rrugës. Në hotel u pritëm nga Sheikh Mostafa Al-Tawil (Kryetar i Gjykatës së Lartë të Sheriatit në shtetin e Palestinës). Pas prezantimit dhe bisedës së ngrohtë me të, shkuam dhe u takuam me Ministrin e Çështjeve Fetare dhe Vakëfëve Mahmud El-Hebbash.

Pas vizitës të shkurtër me Ministrin e Çështjeve Fetare dhe Vakëfëve, u nisëm për në Ramallah. Atje vizituam muzeun e Jaser Arafatit dhe u surprizuam me këtë muze. Në muze përmblidheshin disa koncepte në një.

Aty ishte varri i Jaser Arafatit, i cili ruhej nga dy ushtarë gjatë gjithë kohës. Në muze ndodhej shtëpia, zyra, studioja dhe bunkeri ku Arafati i rezistoi izraelitëve deri sa vdiq. Në brendësinë e tij, ishte shkruar edhe historia e përgjakshme e Palestinës, e cila shprehej me anë të fotove, pikturave, letrave dhe dokumenteve.

Në një pikturë gjigante, që ishte vënë në hyrje të pavionit historik të muzeut, ishin vendosur të gjithë heronjtë e Palestinës. Ndërsa në qendër të saj qëndronte Jaser Arafati.

Kënaqësia që na dha muzeu madhështor vazhdoi me faljen e namazit të drekës, ikindisë dhe me darkën e shtruar për nderin tonë. Darka na dha mundësinë që të marrim informacion edhe më shumë lidhur me Palestinën. Më pas rruga jonë vazhdoi për në hotel.

Dita e dytë:

Në vazhdim, Sheikh Mostafa Al-Tawil (Kryetar i Gjykatës së Lartë të Sheriatit në shtetin e Palestinës) na shoqëroi për të vizituar kishën e Ringjalljes. Tregohet se kur Omer ibnul-Hattabi (r.a) mori në dorëzim qytetin e Kudsit (Jeruzalemin) dhe erdhi koha për t'u falur, patriarku i qytetit, u afrua dhe i propozoi të falej në kishën e Ringjalljes. Por Omeri iu përgjigj me fjalë që u përjetësuan në histori: "Jo pasha Zotin, nuk falem në kishë. Nuk falem sepse kam frikë se muslimanët që do të vijnë pas meje, do të thonë: "Këtu është falur Omer ibnul-Hattabi!" dhe do e prishin kishën për të ndërtuar xhaminë."

Pas kësaj vizite na priste një vizitë më e këndshme për tek xhamia Aksa ku edhe qëllimi i vajtjes sonë në këtë vend ishte pikërisht vizita e kësaj xhamie historike.

"(O Allah) Kush vjen në këtë xhami, jo me qëllim tjetër, përveç namazit, pastroje prej gjynaheve si ditën që ka lindur nga nëna e tij!"

Hyrja për në xhaminë Aksa kontrollohej nga ushtarët izraelitë të cilët i kërkonin dokumentet vizitorëve dhe i pyesnin për fenë e tyre dhe disave u kërkonin të thonë shehadetin. Kur hyn brenda në oborrin e xhamisë Aksa shtangesh. Bukuria e Kubetus-Sahrasë (Kupolës së Shkëmbit), e Xhamisë Aksa dhe e vakëfëve të tjera që janë në Faltoren e Jeruzalemit, të mahnisin. Zemra, duart e këmbët të dridhen. Besimtari emocionohet kur sheh për herë të parë vendin e bekuar, ku kanë predikuar shumë profet të Zotit dhe ku profeti Muhammed (a.s) u ngjit për në qiell.

Pasi i falëm dy rekatë namaz poshtë kupolës së shkëmbit, iu lutëm Allahut që ta ruajë Xhaminë e Shenjtë. Më pas Sheikh Mostafa Al-Tawil na prezantoi me Myftiun e Palestinës (Sheikh Mohammad Ahmad Husein) si dhe me drejtorin e Vakëfit dhe njëkohësisht drejtorin e Xhamisë Aksa, (Sheikh Omar Avdallah Kisuanin). Myftiu na foli rreth xhamisë së shenjtë dhe na tregoi hallet që muslimanët përjetonin çdo ditë në Jeruzalem. Më pas u takuam edhe me guvernatorin e Palestinës, z. Adnan Ghaith.

Pas vizitës së xhamisë Aksa vizituam edhe Mesxhidul-Burak (vendi ku është lidhur kafsha që çoi Profetin Muhammed (a.s) nga Qabja në Mesxhidul-Aksa. Në këtë xhami falëm edhe dy rekatë të tjera namaz.

Në xhaminë Aksa së bashku me grupin falëm edhe namazin e xhumasë ku xhamia ishte e tejmbushur. Ajo kishte dy kate lutjesh, një nën tokë e një mbi tokë. Falja e namazit në këtë xhami është një emocion i pa përshkruar, pasi do të thotë të falësh në të njëjtin vend ku është falur profeti Muhammed (a.s) me profetët e tjerë.

Pas namazit të xhumasë shkuam për drekë me Myftiun, Guvernatorin dhe me disa pjesëtarë të stafit të tyre. Pas ngrënies së drekës u nisëm për në Betlehem. Betlehemi ishte 9 km larg nga qendra e Jeruzalemit.

Në Betlehem vizituam Kishën e Lindjes së Jezusit (sipas të krishterëve). Po ashtu vizituam edhe xhaminë përballë kishës që quhej xhamia e Omer ibnul-Hattabit (r.a). Pas Betlehemit shkuam në hotel. Kur erdhi koha e jacisë shkuam me grupin në xhaminë Aksa dhe e falëm namazin atje. Të gjithë u lutëm, që Allahu të na mundësojë sërish vizitën e kësaj xhamie dhe të mos na dalë shpirti pa e vizituar edhe një herë këtë vend të bekuar!"...

Dita e mbushur plot me vizita të tilla ishte e shkurtër dhe dëshironim që të mos përfundonte, por darka na mblodhi gjithsesi.

Mikpritësit morën falënderime të shumta nga grupi ynë, që na priten dhe na shoqëruan në këtë vizitë që për ne ishte historike.

Në radhë të parë falënderojmë Zotin që na e mundësoi për ta vizituar këtë vend të shenjtë. Më pas falënderimet e sinqerta shkojnë për Myftiun e Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, për zv. Ambasadorin e Palestinës Hani Husejn dhe për hoxhën e xhamisë së Parrucës Durim Kasemin, që me përkthimet e tij kontribuoi për udhëtimin tonë.

Këtë shkrim dua ta përfundoj me një hadith të Pejgamberit (a.s), i cili ka thënë: Kur Sulejmani (a.s) e përfundoi rindërtimin dhe zgjerimin e xhamisë Aksa, i është lutur Allahut: (O Allah) Kush vjen në këtë xhami, jo me qëllim tjetër, përveç namazit, pastroje prej gjynaheve si ditën që ka lindur nga nëna e tij!".[8] Pasi e tregoi këtë lutje të Sulejmanit (a.s) Profeti ynë, (a.s) tha: "Shpresoj që Allahu t'i jetë përgjigjur lutjes së Sulejmanit (a.s)."[9]

Edhe unë i lutem Allahut të madhëruar që inshaAllah na e ka pranuar adhurimin dhe lutjet që kemi bërë në këtë xhami për veten tonë, për familjet tona, për xhematet e krejt xhamive tona, për Shkodrën dhe për mbarë Shqipërinë.

(Fjala e mbajtur me rastin e kthimit nga Kudsi Sherifi, ditën e enjte, më 24 janar 2019, në Grand Hotel Europa)

8. Nesaiu.
9. Ibn Maxhe.

ANALIZË E FINANCAVE TË MYFTINISË SHKODËR PËR VITIN 2018

Ditën e martë, më 8 janar 2019, në Myftininë e Shkodrës u zhvillua një mbledhje e detajuar mbi raportin e financave dhe vakëfeve për vitin 2018.

I pranishëm në këtë takim ishte edhe nën/kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, që shoqërohej edhe nga drejtori i vakëfit në KMSh, z. Edison Hoti, drejtori i financave, z. Alban Feti dhe avokati i KMSh-së, z. Sokol Mara.

Gjatë analizës së detajuar u vlerësua rëndësia që ka shfrytëzimi maksimal i vakëfeve dhe roli i tyre në mbështetjen e aktivitetit të Myftinisë Shkodër.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Myftinisë Shkodër, u komunikua edhe vendimi i Kryesisë së KMSh-së për shkarkimin nga detyra të menaxherit të Qendrës Tregtare Zdralej, Besmir Selmani, për shkelje të rënda në detyrë.

U dhanë udhëzime për vitin 2019, si dhe u diskutuan disa tematika që lidhen me çështjen e vakëfit në Shkodër.

INSPEKTOHEN PUNIMET TE XHAMIA E LAGJES DRAÇIN

Pasdrekën e së martës, më 8 janar 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga Drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, zhvilloi një inspektim në terren, për të parë nga afër nivelin e punimeve për xhaminë e re të lagjes Draçin.

Xhamia në fjalë po ndërtohet në vakëfin e vjetër, në të njëjtin vend ku ka ekzistuar xhami edhe para vitit 1967.

Myftiu e falënderoi kontributin e madh të Fondacionit "Mirësia" në rrugën e ngritjes së xhamive të reja në mbarë vendin, si dhe mbështetjen e madhe dhënë Myftinisë Shkodër në përpjekjet për ndërtimin e xhamive të reja në çdo lagje muslimane dhe fshat, ku muslimanët kanë nevojë për xhami.

"Sharjet dhe fyerjet, o vëllezër e motra, nuk udhëzojnë të devijuar, as ngrohin zemër, as bashkojnë rreshta, as e çlirojnë atdheun, as ngrejnë shtet, as afrojnë me All-llahun e Madhëruar!"

- Prof. Isam El-Attar,
(mendimtar sirian, jeton në Gjermani)

MYFTIU: "KUR'ANI, SHPRESË DHE BALSAM PËR SHOQËRITË E SOTME!"

Nëpërmjet hytbes së xhumasë, ditën e sotme, më 25 janar 2019, nga minberi i xhamisë së "Dy Vajzave", Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha mesazhe shpresëdhënëse për realitetet e sotme, nëpër të cilat kalon njerëzimi.

Duke iu referuar sures "El-Hixhr", Myftiu tha se, përtej vështirësive dhe brengave me të cilat përballet shoqëria e jonë dhe njerëzimi, sureja "El-Hixhr" mbetet përherë një cak reflektimi dhe një thirrje drejt shpresës në jetë.

Ai tha se kjo sure iu shpall të Dërguarit të All-llahut, në një moment të vështirë të jetës së tij në Mekë, pas vdekjes së axhës së tij, Ebu Talibit, si një mbështetje e madhe për të dhe udhëzim për besimtarët deri në ditën e kijametit.

"Po të shohim me vëmendje përmbajtjen e 99 ajeteve të kësaj sureje, do të gjejmë se, besimtarëve u është dhënë një garanci e madhe nga Zoti i gjithësisë për fenë, qiellin dhe tokën, rizkun dhe mbrojtjen nga shejtani i mallkuar! Le të shohim njerëzit poshtë nesh dhe ta falënderojmë All-llahun e Madhëruar për mirësitë që na ka dhënë!" – tha ndër të tjera Myftiu në hytben e tij.

Ai tha se gjatë leximit të sures "El-Hixhr", jemi të ftuar të kuptojmë se Kur'ani Famëlartë me krejt udhëzimet e tij, mbetet shpresë dhe balsam për shoqëritë njerëzore!

HAPET KURSI I PARË FETAR NË XHAMINË E RE TË URA E BUNËS

Ditën e xhuma, më 25 janar 2019 përgjegjësi i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim më nxënësit e parë që janë regjistruar në kursin fetar të xhamisë së re tek Ura e Bunës, e përuruar para dy muajve.

Teologu Halluni gjatë një bisedë të shkurtër përgëzoi pjesëmarrjen e fëmijëve të lagjes tek Ura e Bunës në programin e mësim-besimit si dhe i nxiti të jenë të pranishëm vazhdimisht në këtë kurs të rëndësishëm fetar, i cili do të përçojë besimin islam, sjelljen e mirë dhe moralin e pastër. Ndër të tjera, teologu Halluni tha, se krahas procesit mësimor do të ketë organizime të ndryshme arsimore dhe argëtuese.

I pranishëm në këtë takim ishte edhe mësuesi i përkushtuar i këtij kursi fetar, hoxhë Taksim Plori.

NË MËSHIRËN E ALL-LLAHUT, H. METUSH META

Ndërroi jetë në moshën 94 vjeçare myezini i njohur i xhamisë së Bërdicës së Sipërme (te Harku), H. Metush Meta.

Para pak ditëve, pikërisht më 17 janar 2019 ndërroi jetë muezini i xhamisë Bërdicë e Sipërme (te Harku), H. Metush Meti.

H. METUSH META

Përveç detyrës si myezin që e kreu për 28 vite me përkushtim dhe me vullnet të madh, ai njihet edhe si njëri prej aktivistëve më të njohur në zonën e Bërdicës për përhapjen e besimit, për mirëmbajtjen e xhamive si dhe për të ndihmuar në çdo kohë dhe situatë në zgjidhjen e problemeve dhe nevojave që kishte xhamia, ku ai shërbente.

Në dhjetor të vitit 2016, Haxhi Metush Meta, është nderuar nga Myftinia Shkodër me "Certifikatë Mirënjohjeje" për punën dhe angazhimin e tij fisnik në shërbim të Islamit dhe myslimanëve.

Në faljen e xhenazes përveç familjarëve, miqve, dashamirëve morën pjesë edhe imamë të zonës, si dhe përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përcolli ngushëllimet e sinqerta për familjarët me lutje që All-llahu (xh.sh.) ta mëshirojë dhe qoftë prej banorëve të xhennetit!

MYFTIU PRITI DREJTORIN E FONDACIONIT "MIRËSIA"

Ditën e martë, më 29 janar 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt drejtorin e Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja.

Gjatë takimit, Myftiu shprehu mirënjohjen e Myftinisë Shkodër për bashkëpunimin e deritanishëm me Fondacionin "Mirësia", sidomos në drejtim të ndërtimit të xhamive të reja në Shkodër, si dhe ndihmat e herëpashershme për shtresat në nevojë, etj.

Në qendër të këtij takimi ishte xhamia e re e lagjes Draçin, në fazë përfundimi, Qendra Kulturore në fshatin Oblikë, si dhe fillimi i punimeve për themelet e xhamisë së re në fshatin Shirq.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër ju fton të merrni pjesë në ceremoninë e hedhjes së themeleve për xhaminë e re në fshatin Shirq, ditën e enjte, më 31 janar 2019, duke nisur nga ora: 10.00.

XHAMIA E MILANIT, NË PRAG TË ZBUKURIMIT ME MINAREN E SHUMËPRITUR

Që nga viti 2007, kur u inaugurua dhe deri më sot, xhamia e fshatit Milan/Rrasek në zonën e Postribës vazhdon të mbetet pa minare.

Për kushtet e kohës, kur u ndërtua, ishte një sihariq i madh për zonën. Por, përtej këtij fakt, interesimi i besimtarëve për plotësimin e xhamisë ishte i vazhdueshëm.

Duket se, pas shumë vitesh, momenti i shumëpritur për besimtarët dhe Myftininë e Shkodrës, ka mbërritur.

Një besimtar vendas, ka ofruar një shumë të konsiderueshme, që lejon fillimin e ndërtimit të minares së kësaj xhamie.

Për këtë, ditën e mërkurë, më 30 janar 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari ishte në terren për të parë dhe diskutuar mundësitë e fillimit sa më shpejt të punimeve për minaren e xhamisë së Milanit.

Dëshira dhe lutjet janë që Ramazani i sivjetshëm ta gjejë xhaminë e tij fshati me minare. All-llahut të Madhëruar i lutemi të na japë mbarësi dhe sukses! Amin!



"Shërbimi ndaj Islamit ka nevojë për një njeri, i cili posedon dy elementë, ku asnjëri prej tyre nuk mund të bëjë pa tjetrin: I pari: Sinqeriteti i thellë ndaj Allahut, dhe I dyti: Zgjuarsia e thellë dhe të kuptuarit e pjekur në të vështruarit e gjërave sipas natyrës së tyre".

(Shejkh Muhamed El-Gazali)

U HODH GURI I THEMELIT PËR XHAMINË E RE NË SHIRQ

Paraditën e së enjtes, më 31 janar 2019, në vakëfin e shenjtë të fshatit Shirq, Dajç, u zhvillua ceremonia e hedhjes së gurit të themelit për xhaminë e re.

I pranishëm në këtë ceremoni, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, tha se sot, të gjithë duhet të bashkojmë duart për të përhapur shpresë e dashuri në shoqëri, për të jetuar me dinjitet si njerëz, që dinë të mbajnë amanetet e Zotit në tokë.

Myftiu falënderoi Fondacionin "Mirësia" dhe drejtorin e sak, z. Korab Kaja, për mirësinë e madhe të bashkëpunimeve të shumta, si dhe ndërmjetësimin bujar për arritjen e kësaj dite dhe fillimin e punës për ndërtimin e xhamisë së re në fshatin Shirq.

Ceremoninë e përshëndeti edhe Kryetari i Njësisë Administrative Dajç, z. Gjovalin Derregjati, i cili uroi mbarësi dhe sukses në ndërtimin e shtëpisë së Zotit. Njëkohësisht shprehu dëshirën e tij që ky vend të gjallërohet nga rinia dhe besimtarët.

Në fjalën e tij përshëndetëse, z. Korab Kaja shprehu mirënjohjen e tij për bashkëpunimin e deritanishëm me Myftininë Shkodër, sikurse theksoi se xhamia e re do të ndërtohet me donacionet bamirëse të një besimtari nga Shteti i Kuvajtit.

Me tekbire dhe lutje, u zhvillua edhe ceremonia e hedhjes së gurit të themelit, me dëshirën e madhe që xhamia e re të ndërtohet sa më shpejt brenda kushteve bashkëkohore.

Xhamia aktuale e Shirqit, e ndërtuar pas vitit '90 është përmbytur disa herë dhe prej vitesh në Myftininë e Shkodrës kanë ardhur ankesa për gjendjen e saj.

Imami i kësaj xhamie, H. Kujtim Cufaj, është interesuar vazhdimisht për arritjen e kësaj dite të begatë për mbarë komunitetin.

NJË MBRËMJE E BEGATË FETARE NË XHAMINË E TOPHANËS

Ditën e enjte, më 31 janar 2019, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë e Tophanës një tribunë fetare me temë: "Të afruarit me All-llahun, si ta kuptojmë?".

Në krye të herës, Myftiu kërkoi nga të pranishmit që të lexojnë një "Fatiha" për shpirtin e komandantin legjendar, Hasan Riza Pasha, i cili u martirizua më 30 janar 1913 në Shkodër, në një kohë që Shkodra ishte rrethuar nga fqinjët malazezë.

Sipas programit, ligjërata e parë u mbajt nga Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, që hodhi dritë mbi tre elementët kryesorë, që ndikojnë në rregullimin e rrugëtimit të besimtarit drejt lartësimit në marrëdhënie me Zotin e tij.

Besimi, përkushtimi dhe sinqeriteti i zemrës, u përcaktuan nga Myftiu si boshti kryesor i ekuilibrit që duhet të dëshmojë besimtari në jetën e tij, për të fituar dashurinë dhe përkujdesjen e All-llahut të Madhëruar.

Aktiviteti vijoi me ligjëratën e imamit të nderuar të xhamisë së "Dy Vajzave", teologut Lavdrim Hamja.

Në fjalën e tij, imami u përqendrua tek rëndësia që kanë adhurimet e përgjithshme në lartësimin e besimtarit në jetë.

Ai tha se sinqeriteti i zemrës është elementi kryesor që ndikon në saktësinë e dëshmimit si musliman i përkushtuar në jetë.

Njëkohësisht u ndal tek realitetet e përditshme me të cilat përballet besimtari në jetën e tij dhe rolin e madh që kanë adhurimet, sidomos namazi, në arritjen e paqes së brendshme dhe begatisë në jetë.

Aktiviteti vijoi me bashkëbisedimin e ngrohtë në shoqërinë e hurmave të Medines, si dhe faljen e namazit të jacisë me xhematë në xhaminë e "Dy Vajzave".

Kushtuar Heroit të Madh të Shkodrës, komandantit të paharruar, Hasan Riza Pasha (1871 – 1913)

"Ju la amanet djalin tem, por mos i thoni se më kanë vra, por ra duke luftue!

Betohuni se do të qëndroni për mbrojtjen e atdheut deri në vdekje!"

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek